



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.143/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarëanëtarë, me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor, Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Prishtinë, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Gjilan i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2,700.00 (*dymij e shtatëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07 qershor 2017, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017, në rrugën nga qendra e Gjilanit në drejtim të Prishtinës qytetit të Gjilanit kemi vërejtur se në kundërshtim me rregullat zgjedhore është vendosur poster i kandidatës për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV). Me këtë rast parashtresuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 4.1 pika b i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr.11/2013, neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr.13/2014, vendosja e materialit zgjedhor në objekte publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët. PZAP-it i ka kërkuar krahas autorizimeve ligjore që bartë, të ndërmarrë veprimet e saj bazuar në ushtrimin e kompetencave.

PZAP-i, me datë 07.06.2017 i ka dërguar Kërkesë për Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarrë Masa Përmirësuese subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, mirëpo subjekti politik LVV nuk ka vepruar sipas kërkesës për përgjigje dhe urdhërit për ndërmarrjen e masave përmirësuese, pasi që nuk është përgjigjur në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, gjeti se :

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës, shihet qartë se posteri i kandidatës për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Besa Baftiu nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV dega në Gjilan, është e vendosur në një objekt, pra në hapsirë publike të qytetit, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) i LZP-së e cila e përcakton decidivisht “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e theksuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik LVV, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatës për deputete nga subjekti politik LVV, është vendosur në një objekt publike, në qendër të qytetit të Gjilanit. Për të cilën shkelje subjekti politik LVV nuk është përgjigjur në ankesë sipas kërkesës për përgjigje i datës 07.06.2017 .

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftu me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është përsëritur vazhdimisht gjatë procesit zgjedhor dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatës për deputete nga ky subjekt politik është i vendosur në një objekt publik, në qendër të qytetit. Po ashtu si rrethanë. PZAP-i e morri edhe faktin që subjektit politik në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur sipas ankesës, ashtu që nuk e ka pranuar përgjigjen nga ana e tyre, veprim i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.143/2017 të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që “*Tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në*

procedim". Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.143/2017 më datën 09.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.